

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajt Korrik, 2024

Nis konsultimi publik i Strategjisë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030

22.07.2024 - 25.07.2024: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në ushtrim të rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, znj.Adea Pirdeni, njoftoi publikisht fillimin e konsultimit të draft Strategjisë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030, është dokumenti kryesor i qeverisë shqiptare që programon ndërhyrjet ligjore, institucionale, garanton performancën e administratës publike dhe të autoriteteve publike, në nivel politikash, ekzekutivi, dhe të administratës së sistemit gjyqësor për të luftuar korrupsionin. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030, jetëzon angazhimet e Shqipërisë për luftën kundër korrupsionit dhe si prioritet i integritetit evropian.



Java e konsultimit publik të Strategjisë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030, mbledhi bashkë në katër takime të dedikuara grupe interesi, opinionet, qendrimet dhe sugjerimet e të cilëve, aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë, për adresimin e interesave në funksion të forcimit të luftës kundër korrupsionit. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, nxit bashkëpunimin e organeve të administratës publike, qendrore dhe vendore, me institucione joqeveritare dhe sektorit të biznesit. Pjesë integrale e kësaj strategjie është plani i veprimit të saj, i cili parashikon nisma konkrete, të matshme, të orientuara kah rezultateve.

Dita e parë (22.07.2024) e konsultimit publik për draft-Strategjinë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, filloi me pjesëmarrjen institucionale të autoriteteve publike zbatuese, mbi 30 institucione që kanë dhënë kontributin e tyre parësor në formësimin e strategjisë. Në takim u bë prezantimi i draftit të strategjisë, u theksua se mbetet një sfidë forcimi i koordinimit institucional, si një element kyç për suksesin e luftës kundër korrupsionit. Vizioni i strategjisë është: të krijojë institucione publike që funksionojnë me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, duke ofruar shërbime efikase për qytetarët.



Dita e dytë (23.07.2024) e konsultimit publik për draft-Strategjinë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, mbledhi përfaqësues të Bizneseve dhe Dhomave të Tregtisë e Shoqatave. Takimit iu bashkua edhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Klimën e Biznesit, znj.Delina Ibrahimaj, me qëllim tërheqjen e komenteve dhe sugjerimeve për të adresuar shqetësimet dhe idetë e biznesit. Nxitja dhe promovimi i integritetit në sektorin privat është një nga risitë e kësaj strategjie, që do zhvillohet në partneritet me organizatat e biznesit që operojnë në Shqipëri. Një element thelbësor në luftën kundër korrupsionit është rritja e ndërgjegjësimit publik, përfshirë komunitetin e biznesit, i cili ka një rol të rëndësishëm në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Dita e tretë (24.07.2024) për draft-Strategjinë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, mbledhi përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të medias dhe të botës akademike/universitetet. Në këtë takim u fol mbi qëllimet e strategjisë së re, e cila synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit kundër korrupsionit, përmes forcimit të edukimit mbi integritetin në sistemin arsimor para-universitar, përgjatë të gjithë cikleve të tij, si dhe forcimin e edukimit të sektorit publik, me qëllim garantimin e një sektori publik përgjegjës dhe llogaridhënës para shoqërisë. Politikat kërkimore me qëllim rritjen e programimeve dhe ndërhyrjeve në fusha dhe sektorë me efekte parandalimi u sollën me interes nga tryeza.




Takimet e konsultimeve publike për draft Strategjinë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030 u mbyllën në ditën e katërt (25.07.2024), në tryezën me përfaqësues të institucioneve të Vetëqeverisjes Vendore, ku i pranishëm ishte dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, z.Arbjan Mazniku. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030 ka një risi që është adresimi i çështjeve të integritetit dhe korrupsionit në nivel vendor, duke marrë në konsideratë se këto institucione jo vetëm mbeten ofrues të një numri të konsiderueshëm shërbimesh në nivel vendor, por edhe menaxhues të fondeve publike.

Të dhëna të detajuara për këto takime mund të gjenden në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion **LinkedIn**, **Facebook**, **Instagram**, **Twitter**, **Threads**

Draft Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, e hapur për konsultim publik deri në 31 gusht 2024

22.07.2024: Pas një pune 18 mujore dhe me angazhimin e ekspertëve të administratës publike shqiptare e të asistencës e ekspertizës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, EU4GG, ka përfunduar hartimi i draftit të Strategjisë Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, së bashku me Planin e Veprimit dhe Pasaportën e Treguesve. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, përfaqëson një dokument të qeverisë shqiptare me zotime konkrete të të gjithë institucioneve që ushtrojnë kompetenca në drejtim të parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimit në drejtim të luftës kundër korrupsionit, përfshirë këtu, institucione publike në nivel qendror dhe vendor, institucione të pavarura si dhe institucione ligj-zbatuese dhe ato që i përkasin gjyqësorit (prokurori e posaçme dhe gjykata të posaçme). Strategjia e re paraqet një qasje të re me ndërhyrje sistematike në sektorët vulnerabël ndaj korrupsionit (prona, shëndetësi, arsim, taksat e tatimeve, prokurim publik e konkencione), forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit, shtrirjen e masave të parandalimit të korrupsionit në pushtetin vendor, promovimin e integritetit në biznes, konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit institucional përgjegjës për hetimin dhe gjykimin e korrupsionit, si dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve mbi ligjshmërinë dhe integritetin. Ky kuadër i ri strategjik garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucione shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si një ndër fushat kyçe të avancimit të shtetit të së drejtës. Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030 konsiston në 3 qëllime politikash (parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim), 16 objektiva specifike (parandalimi 9, ndëshkimi 3, ndërgjegjësimi 4), 60 masa, 281 aktivitete, dhe 25 tregues të performancës. Draft Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, do të qendrojë e hapur për konsultim publik në regjistrin e akteve dhe të njoftimeve publike deri më datë 31 gusht 2024.



Dokumenti i draft strategjisë, 2024-2030, është publikuar në faqen online të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në link: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/765>.

Draft Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, diskutohet në takimin e Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian



22.07.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në takimin e dytë për vitin 2024, të Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe kriteri politik, të drejtuar nga Zëvendësministri i Drejtësisë, njëkohësisht negociator, z.Tedi Dobi. Në takim u prezantua dhe u diskutua draft Strategjia Ndër-sektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030, paketë e plotë. Drejtori i Programeve dhe Politikave Antikorrupsion, znj. Rovena Pregja, shpjegoi përmbajtjen e dokumentin të ri strategjik të Qeverisë Shqiptare, për vitet 2024-2030, si instrumenti kryesor që do të zbatohet angazhimin nr.1 të marrë në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, komponenti: Lufta kundër korrupsionit. Takimi i Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian për Kapitullin 23, mori në shqyrtim parashikimet e strategjisë kundër korrupsionit kryesisht risitë e strategjisë dhe angazhimet që parashikohen të ndiqen dhe zbatohen me organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri. Këto organizata që janë edhe auditori dhe monitoruesi kryesor i Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian, parashikohen të jenë bashkë-zbatuese të strategjisë dhe promotori i zhvillimit dhe forcimit të mekanizmave të integritetit dhe të luftës kundër korrupsionit në vitet 2024-2030. Edukimi kundër korrupsionit, bashkëpunimi me shoqërinë civile nëpërmjet programeve të zhvillimit, tryezave, fushatave të ndërgjegjësimit, masa dhe aktivitete me median dhe akademine, të cilat mund të gjenden të plota në përmbajtje të Planit të Veprimit, si pjesë e politikës së 3-të: Ndërgjegjësimi dhe edukimi kundër korrupsionit, u lexuan në këtë takim dhe për të cilat u morën edhe komentet e para nga organizatat, anëtare të Platformës.




Dokumenti i draft strategjisë, 2024-2030, është publikuar në faqen online të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në link: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/765>.

Komisioni Evropian promovon rezultatet e luftës kundër korrupsionit të Shqipërisë në Raportin për Shtetin e së Drejtës, 2024

24.07.2024: Komisioni Evropian publikoi raportin e tij të pestë vjetor për sundimin e ligjit, 2024 (Rule of Law Report). Raporti merr në shqyrtim zhvillimet e sundimit të ligjit në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, dhe për herë të parë raporti ka edhe një kapitull të veçantë mbi zhvillimet e fushës së ligjit dhe së drejtës për vendet candidate, sikurse është Shqipëria. Raporti merr në vlerësim disa komponentë, ku fusha e luftës kundër korrupsionit është pjesë e pandarë. Komisioni Evropian nëpërmjet strukturave të tij në Tiranë, takimeve dhe misioneve fakt-mbledhëse, dhe burimeve të tjera si organizata të shoqërisë civile dhe media, evidenton disa gjetje të fushës. Përkatesisht, raporti flet për zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit për vitet 2015-2023 dhe gjithashtu përgatitjen e Strategjisë së re Antikorrupsion për vitet 2024-2030. Kuadri ligjor për të luftuar korrupsionin është përgjithësisht i konsoliduar. Vërehen rezultate fillestare inkurajuese nga SPAK dhe gjykatat e SPAK, megjithatë, autoritetet e specializuara për ndëshkimin dhe parandalimin e korrupsionit theksojnë mungesa sa i përket burimeve dhe mjeteve të specializuara që kanë në dispozicion. Numri i personave të hetuar, proceduar penalisht dhe të dënur për vepra korrupsioni ka qenë në rritje gjatë tre viteve të fundit. Përdorimi sistematik i hetimeve financiare dhe konfiskimit të aseteve është përmirësuar, megjithëse fusha e kufizuar e veprimit të tyre ndikon në arritjen e rezultateve të pritshme. Raporti evidenton koordinimin midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse ligj-zbatuese disi të dobët. Përgjithësisht, korrupsioni gjendet i përhapur në shumë fusha, duke përmendur edhe gjatë fushatave zgjedhore. Masat parandaluese kanë një kuadër ligjor tepër kompleks dhe vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar, veçanërisht në sektorët vulnerabël si: sektori i shëndetësisë, arsim, prona dhe polici. Mungon transparenca në procedurat e prokurimit publik, sidomos për PPP ndërkohë që digjitalizimi ka ndihmuar vetëm në frenimin e korrupsionit të vogël. Raporti nuk jep rekomandime për vendin, por vlen gjithashtu të përmendet se gjithçka është përmendur si problem në këtë raport ka gjetur adresimin e tij me masa për ndërhyrje në Strategjinë e re të luftës kundër korrupsionit, 2024-2030.



Raporti për Shtetin e së Drejtës të Komisionit Evropian mund të gjendet i publikuar në link: https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf



Rrjeti i Agjencive Parandaluese Antikorrupsion zhvillon seancën plenare për 2024

09.07.2024: Rrjeti i Agjencive Parandaluese të Korrupsionit pranë Këshillit të Evropës, NCPA, zhvilloi takimin plenar, të parin nën drejtimin e Agjencisë Franceze të Antikorrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit u përfaqësua në këtë takim nga drejtori i Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, znj. Rovena Pregja. Rrjetit të Agjencive Parandaluese të Korrupsionit iu bashkuan në rolin e vëzhguesit vende si Portugalia dhe Libia, të cilat ofruan prezantime të agjencive të tyre me kompetenca të luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu, pjesë e takimit u bë edhe ndarja e informacioneve mbi webinarin e zhvilluar në 15 maj 2024, me temë: Korrupsioni në sport, kuadri ndërkombëtar dhe qasja kahsimore në parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit të aplikuar në vendet organizatore olimpike. Disa prej vendeve anëtare të NCPA kishin marrë pjesë në webinar dhe ndanë opinionet e tyre duke kërkuar replikimin të tilla eventeve. Eksperienca e Shqipërisë për krijimin dhe ndarjen e e-buletinit mujor antikorrupsioni u përmend si një eksperiencë e mirë, duke filluar të lancohet edhe për këtë organizëm.

Informacione dhe të dhëna për Rrjetin NCPA mund të gjeni në link: <https://www.coe.int/en/web/corruption/ncpa-network>